



ALPEX
Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike

Raporti

Vjetor

2024

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX Sh.a

ALPEX është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe operimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike për zonat e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës. Është emëruar nga ERE dhe ZRrE si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë (NEMO).

- Më datën 11 prill 2023 u krye ankandi i parë për ditën e livrimit 12 prill 2023 në Tregun e Ditës në Avancë për zonën e ofertimit të Shqipërisë.
- Më datën 31 janar 2024 u krye ankandi i parë për ditën e livrimit 1 shkurt 2024 në Tregun e Ditës në Avancë për zonën e ofertimit të Kosovës, duke shënuar bashkimin e tregut të Ditës në Avancë Shqipëri-Kosovë.
- Më datën 11 dhjetor 2024 u krye ankandi i parë për ditën e livrimit 12 dhjetor 2024 në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë për zonën e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës, duke shënuar bashkimin e këtij tregu ndërmjet dy vendeve.

Përgjegjësitë dhe funksionet bazë të ALPEX

Operimi i platformës elektronike të Tregimit dhe Klerimit

- Regjistrimi i Anëtarëve të Bursës.
- Sigurimi i aksesit të Anëtarëve të Bursës në ETSS për dorëzimin e urdhërporosive.
- Publikimi i rezultateve të tregut për tregjet e ALPEX-it.
- Klerimi dhe Shlyerja e Transaksioneve.

Menaxhimi i Tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike

- Administrimi i kërkesave për Anëtarësim në Bursë dhe si Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit.
- Trajnime dhe certifikime për Agjentët Tregtarë
- Monitorimi dhe mbikëqyerja e Tregut të organizuar

Tregu i Ditës në Avancë -ALPEX

Treguesit Vjetore të tregimit gjatë vitit 2024

- Një volum total prej **1,172,580.58 MWh** i energjisë elektrike u tregtua në Tregun e Ditës në Avancë me një çmim klerues mesatar prej **112.01 €/MWh**.
- Rrjedha e energjisë:
 - Nga Shqipëria drejt Kosovës: **27,816.94 MWh**
 - Nga Kosova drejt Shqipërisë: **241,097.29 MWh**.
- Oferta në blerje: **1,534,425.97 MWh**.
- Oferta në shitje: **1,868,626.34 MWh**.
- Rekordi i tregtimit për një Njësi Kohore të Tregut (MTU) ishte **497.87 MWh** më 19 maj 2024.
- Rekordi ditor i tregtimit ishte **7,816.05 MWh** në 23 maj 2024.
- Rekordi mujor i tregtimit ishte **133,906.13 MWh** në muajin maj.
- Rekordi për rrjedhën e energjisë u regjistrua në qershor me **41,859.80 MWh** nga Kosova drejt Shqipërisë.
- Faturimi total (blerje/shitje) arriti vlerën **301 milionë euro**.

Anëtarë të Rinj të Bursës

Në Vitin 2024, ALPEX mirëpriti 17 Anëtarë të rinj të Bursës në Tregun e Ditës në Avancë dhe 2 Anëtarë të rinj të Përgjithshëm Klerimi.

- Totali i Anëtarëve të Bursës:
 - 36 Anëtarë Burse, dhe
 - 4 Anëtarë të Përgjithshëm Klerimi.

Tregjet e ALPEX-it të Ditës në Avancë		
Viti 2024	Çmimi në DAM (€/MWh)	Volumi në DAM (MWh)
Mesatar ditor	€ 112.01	3,940.32
Max. ditor	€ 452.68	7,816.05
Min. ditor	€ 21.61	1,918.90
Total		1,172,580.58

Performanca e Tregut të Ditës në Avancë (DAM)			
Periudha	Volumet (MWh)	Faturimi Blerje-Shitje (€)	Çmimi Mesatar (€/MWh)
2023	827,541.08	€ 167,702,808	€ 100.15
2024	1,172,580.58	€ 301,013,609	€ 112.01
Ndryshimi (%)	↑ 41.69%	↑ 79.49%	↑ 11.84%


Zona e Ofertimit të Shqipërisë

Periudha	Volumet (MWh)	Faturimi Blerje-Shitje (€)	Çmimi Mesatar (€/MWh)
2023	827,541.08	€ 167,702,808	€ 100.15
2024	807,328.67	€ 171,445,464.32	€ 112.01
Ndryshimi (%)	↓ 2.44 %	↑ 2.23 %	↑ 11.84 %


Zona e Ofertimit të Kosovës

Periudha	Volumet (MWh)	Faturimi Blerje-Shitje (€)	Çmimi Mesatar (€/MWh)
2023	N/A	N/A	N/A
2024	635,396.02	€ 129,741,045.88	€ 114.00
Ndryshimi (%)			


Çmimi mesatar Klerues dhe Volumet e Tregtuara në baza mujore




Çmimi orar Mesatar Klerues në €/MWh - 2024



Volumet mesatare të Tregtuara për MTU - MWh



Volumet ditore në MWh të tregtuara për 2024



Performanca e Tregut të Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë (IDM)

- Një volum total prej **365.53 MWh** i energjisë elektrike u tregtua në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë të ALPEX-it me një çmim klerues mesatar prej **200.80 €/MWh**.
- Rrjedha e energjisë:
 - Nga Shqipëria drejt Kosovës: **167.30 MWh**.
 - Nga Kosova drejt Shqipërisë: **91.15 MWh**.

Anëtarë të rinj në IDM

Në Vitin 2024, ALPEX mirëpriti 14 Anëtarë të rinj të Bursës në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë (IDM).

Tregjet e ALPEX-it të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë		
Viti 2024	Çmimi në IDM (€/MWh)	Volumi në IDM (MWh)
Mesatar ditor	€ 213.16	213.14
Max. ditor	€ 312.97	250.00
Min. ditor	€ 86.00	185.58
Total		365.53